



Planuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	26.05.2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	2658/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Anr. 307/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti anëtarë, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 307/2021, të datës 27.04.2021, të parashtruar nga ankuesi me përfaqësues juridik avokate me adrese banimi rruga „Marie Shllaku”, pa numër He Agmia, nga Komuna e Gjilanit, kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “Kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A. Nr. 307/2021 të datës 27.04.2021, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 27.04.2021, me numër protokollit 2019/21, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e pagës për periudhën nga data 14.11.2011, deri me datë 30.07.2013, pas pranimin të Aktvendimit C. Nr. 154/2021 të datës 18.03.2021, të Gjykatës Themelore në Gjilan, dhe përgjigjes së datës 22.04.2021, me numër protokollit 3879/2, njësisë se personelit të Komunës së Gjilanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.04.2021, me numër protokollit 2143/2021, ka dërguar përgjigjen në kërkesë tek Komuna e Gjilanit, ndërsa Komuna e Gjilanit, me datë 20.05.2021, me numër protokollit 2500/2021, ka dërguar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Administrimi i provave-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 307/2021, me numër protokoll 2019/2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kërkesë e datës 23.04.2021; Autorizimi i datës 08.04.2021; kontrata e punës e datës 14.01.2015; Akt emërimi i datës 16.11.2011; Akt emërimi i datës 30.03.2012; Përgjigje në kërkesë e datës 22.04.2021; kërkesë për pagesën e pagave e datës 05.11.2014; Aktgjykimi i datës 25.03.2018. i Gjykatës Themelore në Gjilan; Aktvendimi A. Nr. 2886/18 i datës 21.01.2021, i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Aktvendimi i datës 18.03.2021, i Gjykatës Themelore në Gjilan; Aktvendimi i datës 12.04.2021, i Gjykatës Themelore në Gjilan; Marrëveshja e datës 03.07.2019, për transferimin e lidhur ndërmjet Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe Komunes së Gjilanit; Përgjigje në ankesë e datës 20.05.2021, me numër protokoll 2500/2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimit ankimore të ankuesit lidhur Kompensimin material, Kolegji ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk eshtë kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruar në ankese në Këshill, për mes përfaqësuesit juridike avokates lidhur me kompensimin e pagës për periudhën 14.11.2011, deri me datë 30.07.2013. Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit ka konstatuar se ankuesi nuk e ka statutin e nëpunësit civil sepse nga shkese e lendes del se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 16.11.2011, mbanë pozitën „Roje Pylli”, duke filluar nga data 14.11.2011.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesit, ka konstatuar se nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj çështjeje, pasi që ankuesit nuk ka status të nëpunëseve civil në bazë të nenit 4 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: „**Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civilë**”, sepse marrëdhënia e tyre e punës nuk i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për shërbimin civil, por lidhet në pajtim me nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “**Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale**”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka marrë parasysh edhe Qarkoren Administrative Nr. 01/2014, datë 08.12.2014 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike, e cila ka definuar listën e të punësuarve në Institucionet e Republikës së Kosovës të cilët janë përjashtuar nga shërbimi civil, në bazë të nenit 4 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku prej pozitës të përjashtuar është edhe pozita e ankuesit.

Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi që ka shpallë jo-kompetencën e Këshillit për të vendosur lidhur me ankesën, konstaton se ankuesi të drejtën e tij mund ta realizoj në pajtim me dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore, me të cilat rregullohet marrëdhënia e punës për kategoritë nëpunësve të administratës të cilët janë të përjashtuar nga shërbimi civil, në pajtim me afatet e përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-212 për Punë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, bazës ligjore të aplikuar në lidhje me këtë çështje administrative si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit sipas nenit 10.1 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A.307/2021

Rushit KAJTAZI

Proçes mbajtës



Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit*
- *Përfaqësuesit juridike avokates Vlora Berisha;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

